Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv),
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. *Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;*

c. *Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;*

ç *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

d. *Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;*

dh. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në objektin e veprimtarisë së tij (QKB) kryerjen e shërbimeve objekt prokurimi.

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të certifikuar të bilancit të vitit të fundit 2019, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore dhe të konfirmuar nga ky autoritet me nënshkrim dhe vulë në çdo faqe të dokumentit, si dhe të shoqëruar me raportin e ekspertit kontabël në rastet kur është e deturueshme sipas legjislacionit në fuqi.

2.2.2 Kopje të deklaratës së xhiros mesatare vjetore e realizuar gjatë tre viteve të fundit (2017, 2018, 2019) të aktivitetit financiar që duhet të jetë sa vlera e fondit limit që do të prokurohet.

2.2.3 Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Për të provuar përvorjen e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme me vlerë jo më të vogël se 40% % të fondit limit pa TVSH, të realizuara në tri vitet e fundit nga data e zhvillimit të tenderit (duke përfshirë kontrata të realizuara deri ditën e hapjes së ofertave).

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

Në rastin e përvorjes së mëparshme të realizuar me sektorin publik duhet të paraqitet kontrata e lidhur si dhe vërtetimi i lëshuar nga enti publik për realizimin e kontratës. Në rastin e përvorjes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen fatura tatimore e shitjes, ku shënohen data, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; Liçencën profesionale të shoqërisë për “Mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi”, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme:

I. PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

NP-1 Punime gjurmimi në tokë.

NP-2 Ndërtime civile dhe industriale.

NP-3 Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.

NP-5 Punime nëntokësore, ura e vepra arti.

NP-7 a. Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.

NP-11 Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit.

II. PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

NS-1 Punime për prishjen e ndërtimeve.

NS-2 Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.

NS-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.

NS-8 b. Struktura metalike

NS-9 Punime strukturore speciale.

NS-10 Shtresa dhe mbistruktura speciale.

NS-12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.

NS-14 Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

NS-18 Punime topogjeodezike.

NS-19 Sistemet kundra zhurmës për infrastruktur-turë.

NS-20 Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, në plotësim të liçencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

2.3.3 Për efekt të kryerjes së shërbimeve në tërësi, ofertuesi duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 10 (dhjetë) punonjës të siguruar për periudhën Janar 2020 – Prill 2020, dokumentuar me vërtetimin e lëshuar nga administrata tatimore. Gjithashtu ofertuesi duhet të paraqesë listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të konfirmuara nga administrata tatimore përkatëse.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e shoqërisë drejtues teknik të kualifikuar si më poshtë:

Drejtues Teknik Inxhinier Ndërtimi, 1 (një) .

Drejtues Teknik Inxhinier Hidroteknik, 1 (një)

Drejtues Teknik Inxhinier Elektrik/Elektromekanik, 1 (një) .

Drejtues Teknik Inxhinier Topograf / Gjeodet / Markshajder, 1 (një) .

Drejtues Teknik Inxhinier Mjedisit / Kimist Teknolog/ Ekuivalent, 1 (një) .

Drejtues Teknik Inxhinier Gjeolog/Gjeoteknik, 1 (një) .

Për stafin e mesiperm te paraqitet kontrata individuale e punës e lidhur para noterit, Diplomë, CV, Liçencë Profesionale Personale për “Mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi”.

2.3.5 Një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe komponenteve te saj, lista e personelit te përfshihen CV-të e tyre , diplomen, kontraten e punes, Lista e stafit kryesor, te nevojshem per te zbatuar objektin e prokurimit, te permbaje :

Inxhinier Ndërtimi, 2 (dy) .

Inxhinier Hidroteknik, 1 (një) .

Inxhinier Elektrik/Elektromekanik, 1 (një) .

Inxhinier Topograf / Gjeodet / Markshajder, 1 (një) .

Inxhinier Mjedisi / Kimist Teknolog/ Ekuivalent, 1 (një) .

Inxhinier Gjeolog/Gjeoteknik, 1 (një) .

- Drejtuesin e projektit që duhet të jetë inxhinier ndërtimi, me eksperiencë pune në mbikqyrje i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, miratimin e volumeve të punimeve, certifikatën e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimit te volumeve,
- Mbikqyresin e materialeve që duhet të jetë inxhinier ndërtimi, me eksperiencë pune në këtë fushë i cili miraton materialet dhe cilësinë e tyre dhe ndjek e miraton cilësinë e punimeve.
- Mbikqyresin për punimet mekanike që duhet të jetë inxhinier mekanik , me eksperiencë pune i cili kontrollon dhe miraton punimet mekanike dhe teknologjike ne objekt.
- Mbikqyresin për punimet topografike që duhet të jetë inxhinier topograf, me eksperiencë pune i cili kontrollon dhe miraton volumet, piketimet dhe kuotëzimin e objektit.
- Mbikqyrësin (gjeolog), duhet të jetë inxhinier gjeolog me eksperiencë pune i cili kontrollon punimet gjatë gërmimit.
- Mbikqyrësin per punimet e rrjetit te ujesjellesit që duhet të jetë inxhinier hidroteknik, me licence dhe me eksperiencë pune në këtë fushë.
- Mbikqyresin per punimet e mjedist qe duhet te jete inxhinier mjedisi ,teknolog , me licence dhe eksperience pune mbi ne kete fushe.
- Mbikqyrësin per punimet elektrike duhet te jete inxhinier elektrik, me licence dhe me eksperiencë pune vjet në këtë fushë.

2.3.6 Kandidati/ofertuesi te paraqese certifikatat te vlefshme/te perditesuara.

ISO 9001 ; 2015 (Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë)

ISO BS PAS 99 ; 2012 (Për Sistemin e Menaxhimit të Integruar)

ISO 39001 ; 2012 (Për Sigurine ne Trafikun Rrugor)

ISO 14001 ; 2015 (Për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit

ISO 18001 ; 2007 (Për Sistemin e menaxhimit te Shendetit dhe te Sigurise ne pune).

2.3.7 Kandidati/ofertuesi te paraqese certifikatat te tjera te vlefshme/te perditesuara.

- Certifikata ne fushen e mbrojtjes nga zjarri

2.3.9 Ofertuesit duhet të paraqesin një analizë të çmimit të ofruar, duke specifikuar saktë të gjithë elementet që kanë marrë parasysh në llogaritjen e çmimit, si dhe duke plotësuar të gjitha kërkesat

e përcaktuara në VKM nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”.

2.3.10 Në zbatim të rekomandimeve të APP, për llogaritjen e çmimit të ofertës së tyre, Operatorët Ekonomikë duhet të kenë parasysh sa më poshtë: Vlera e ofruar duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e bëra në VKM nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”. Të gjitha ofertat që do të jenë më të ulëta sesa vlerat minimale të lejuara në bazë të parashikimeve të VKM Nr.354 date 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, do të refuzohen.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Mbikqyresi duhet te permbushe te gjitha detyrimet e përcaktuara në legjislacionin ne fuqi në mbështetje të Ligjit Nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit", i ndryshuar, Udhezimit te KM Nr. 3 date 15.02.2001, "Per mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve te Ndertimit", i ndryshuar.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 10

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: Mbikqyrje e punëve ndërtimore për objektin "Rikonstrukcion sektori i depove Peqin".

Afatet e ekzekutimit: Duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës, deri në përfundim të punimeve.

Shërbimi i mbikqyrjes do të zgjatë për gjithë periudhën e zbatimit të punimeve, nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërmarrjes për zbatimin e punimeve të objektit deri në përfundimin e punimeve.

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Zbatimi i punimeve nën shërbimin e mbikqyrjes nga shoqëri të licencuara.

Mbikqyrje punimesh për objektin "Rikonstruksion sektori i depove Peqin"

Detyrat:

Duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek specifikimet teknike, shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit.

Në rast se deshton të kryejë shërbimet sipas përcaktimeve të mesipërme porositësi ruan të drejtën e ndërprerjes të kontratës në përputhje me "Ndërprerja për mosplotësim" të kësaj kontrate.

Kryen të gjitha të drejtat dhe detyrimet të përcaktuara në Udhëzimin nr.3 datë 15.02.2001 "Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", si edhe në Udhëzimin Nr 2 datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".

Për çdo objekt që ndërtohet, mbikëqyrësi mban dhe përgjigjet, për dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Vendimin e KRRT-së për sheshin ose lejen e ndërtimit dhe lejen origjinale të ndërtimit;
- b) Projekt-zbatimin e firmosur nga projektuesit, dhe nga bashkia Peqin, sipas juridiksionit.
- c) Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinierik të themeleve, të bazamenteve dhe të punimeve të maskuara.
- ç) Dokumentacionin përkatës për të gjitha ndryshimet e mundshme që mund të jenë bërë në projekt gjatë ndërtimit të objektit, pa prekur kushtet e vëna në vendimin e KRRT-së.
- d) Plan-organizimin e punimeve.

Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë, periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë e vërtetësinë e dokumenteve që pasqyrohen në të. Në çastin e fillimit të punimeve, mbikëqyrësi duhet të bëjë verifikimet paraprake, si më poshtë vijojnë:

- a) Verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës, të licencave, të autorizimeve dhe të lejeve, të cilat, sipas dispozitave në fuqi, duhet të merren para fillimit të punimeve.
- b) Verifikimin e sheshit të ndërtimit, nëse është i lirë dhe i gatshëm për të filluar punimet.
- c) Njohjen me hollësi të kontratës së sipërmarrjes dhe e të gjitha akteve administrative që lidhen me të, si dhe njohjen e të gjitha ndryshimeve të mundshme të kësaj kontrate me kalimin e kohës.
- ç) Vendosjen e tabelës së identifikimit me të dhënat e mëposhtme:
 - emërtimi i objektit;
 - data e marrjes së lejes së ndërtimit;
 - investitori; - projektuesi;

- sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik;
- mbikëqyrësi;
- afati i ndërtimit;
- sipërfaqja e ndërtimit;

Mbikëqyrësi i punimeve, pas verifikimeve, harton dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Aktin e dorëzimit të sheshit të ndërtimit shoqërisë sipërmarrëse;
- b) Aktin e dorëzimit nga sipërmarrësi të dokumentacionit, teknik dhe administrativ, si licenca, autorizime e leje të marra nga sipërmarrësi.
- c) Shkresën me atë të së cilës njofton pushtetin vendor për fillimin e punimeve.

Mbikëqyrësi i punimeve, gjatë zbatimit të objektit, i jep instruksione dhe urdhëra, me shkrim, sipërmarrësit sa herë që e sheh të nevojshme, në zbatim të akteve, ligjore e nënligjore dhe ky i fundit është i detyruar t'i respektojë ato, por duke ruajtur të drejtën t'i bëjë me shkrim investitorit vërejtjet e tij, për instruksionet dhe urdhrat e mbikëqyrësit të punimeve.

Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të propozojë largimin nga puna të një ose të disa personave nga personeli i sipërmarrësit. Për të realizuar këtë, ai i drejtohet me shkrim titullarit të shoqërisë sipërmarrëse, duke i shpjeguar arsyet. Arsyet kryesore të propozimit për largim mund të jenë moszbatimi i standardeve dhe i rregullave teknike, mosbindja, paaftësia, arbitrariteti në zgjidhjen e problemeve teknike ose pakujdesi të rënda.

Materialet që vijnë në kantier duhet të jenë në përputhje me kërkesat teknike të projektit.

Materialet në vepër përdoren vetëm për miratimin e mbikëqyrësit të punimeve. Materialet e ardhura, si dhe pajisjet e siguruara nga sipërmarrësi, por që nuk pranohen nga mbikëqyrësi, zëvendësohen me të tjera, me shpenzimet e sipërmarrësit. Në këto raste (si për materialet, ashtu dhe për pajisjet) mospranimi duhet dokumentuar me procesverbalet e analizave të provave, së bashku me aktin teknik, ku të argumentohen shmangiet e palejuara, referuar standardeve të detyrueshme shqiptare ose atyre europiane.

Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të kërkojë kryerjen e provave të materialeve të vendosura në objekt, kur këto nuk janë kryer në masën, sipas vëllimeve të realizuara dhe pjesës së lëndës së parë të furnizuar, për të verifikuar cilësinë. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarrësit.

Kur mbikëqyrësi i punimeve mendon se ka defekte në zbatimin e punimeve, kërkon verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë mbikëqyrësit të punimeve, shpenzimet janë në ngarkim të sipërmarrësit, në rast të kundërt, sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve.

Mbikëqyrësi ka të drejtë të pezullojë, përkohësisht, punimet për zbatimin teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, në çdo rast me miratimin e investitorit, për aq kohë sa quhet e nevojshme korrigjimi i gjendjes.

Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon zbatimin e grafikut të hollësishëm të punimeve dhe i raporton çdo muaj investitorit për realizimin e tij.

Asnjë punim nuk do të mbulohet, maskohet a betonohet pa miratimin e mbikëqyrësit të punimeve. Sipërmarrësi duhet të njoftojë mbikëqyrësin kur punimet janë gati për t'u ekzaminuar prej tij.

E gjithë korrespondenca e mbikëqyrësit të punimeve me investitorin dhe me sipërmarrësin, përbën dokumentacionin e objektit dhe, si e tillë, ruhet me çdo kusht.

Mbikëqyrësi i punimeve mban dosjen e mbikëqyrjes së punimeve, ku pasqyrohen të gjitha aktet e mbajtura gjatë zbatimit të objektit, që nga akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, urdhrat e

ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të objektit, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike, të kërkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit, si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjitha fazave të zbatimit të punimeve.

Në rastin e ndërrimit të mbikëqyrësit të punimeve, mbahet procesverbali i dorëzimit të dosjes së punimeve, ku shënohen edhe shkaqet e këtij ndërrimi.

Dokumentacioni i mbikëqyrësit të vjetër i dorëzohet mbikëqyrësit të ri. Investitori mund të kërkojë largimin dhe zëvendësimin e mbikëqyrësit, kur vërtetohen mangësi serioze në veprimtarinë e tij, si:

- Mangësi në plotësimin e detyrave

- Ndërprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre.

-Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet, tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuara ose jo me cilësi.

Sipërmarrësi duhet t'i njoftojë me shkrim mbikëqyrësit të punimeve përfundimin e punimeve.

Me këtë rast, brenda 30 ditëve, ai i paraqet mbikëqyrësit:

a. Kontratën dhe aktet që lidhen me të.

b. Regjistrimin e kontabilitetit.

c. Procesverbalet e fillimit, të ndërprerjes ose të zgjatjes dhe të përfundimit të punimeve.

ç. Certifikatat e provave të materialeve të përdorura, të lëshuara nga laboratorët e autorizuar për këtë qëllim.

d. Deklaratë se objekti është ndërtuar në përputhje me projektin dhe me kushtet teknike.

Për të gjitha problemet e verifikuara prej tij, mbikëqyrësi i punimeve duhet të firmosë gjithçka që ka miratuar. Ai mban përgjegjësi ligjore, së bashku me sipërmarrësin. Një kopje e dokumentacionit, e miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve, i dërgohet kolaudatorit të objektit. Mbikëqyrësi i punimeve merr pjesë në kolaudimin e veprës, i përgjigjet kolaudatorit me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kolaudimin e veprës, si dhe firmos procesverbalin e këtij kolaudimi.

Situacionet e paraqitura nga sipërmarrësi, në fazat e ndryshme të punimeve kontrollohen dhe miratohen nga mbikëqyrësi i punimeve.

Pagesa mund të kryhet vetëm në bazë të këtij miratimi.

Këto dokumente dërgohen në sektorin financiar të punëdhënësit, bashkë me vërtetimin e përkohshëm të pagesës, për të shpallur vlerën e detyrueshme për pagim. Pas përfundimit të kolaudimit, mbikëqyrësi i punimeve, mbështetur në kontratën dhe në dokumentacionin tjetër, përcakton vlerën përfundimtare të objektit, e cila i bëhet e ditur sipërmarrësit, si dhe i jepet për likuidim investitorit.

Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe autorizon përdorimin e fondit rezervë, të preventivuar, dhe i raporton, periodikisht, investitorit për gjendjen e tij. Ky i fundit, nëse ka vërejtje, e njofton sipërmarrësin dhe problemi zgjidhet ndërmjet tyre.

Për çdo ndryshim të mundshëm, mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni, për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve në fjalë

1. Përgjigjet për ndjekjen dhe zbatimin e kontrates.

2. Përgjigjet për ndërtimin e objektit në përputhje me projektin dhe kushtet teknike të zbatimit në fuqi për mbikëqyrjen dhe përshkrimin e projektit .

3. Ben verifikimet paraprake në momentin e fillimit të punimeve.

4. Kontrollon zbatimin e grafikut të punimeve dhe raporton tek investitore cdo 10 dite.

5. Studion plan organizimin e punimeve.

6. Jep kështu me shkrim kontraktuesit për zbatimin e punimeve.
7. Largon nga puna drejtuesin teknik të kontraktuesit të punimeve për mos zbatim të standardeve.
8. Kërkon kryerjen e provave të materialeve
9. Përzullon perkohësisht punimet kur e shikon të arsyeshme. Kjo ndërprerje nuk duhet të zgjasë më shumë se 1/3 e kohezgjatjes së punimeve sipas kontratës së nënshkruar por në çdo rast jo më shumë se 6 muaj.
10. Jep relacion me shkrim investitorit për ecurinë e punimeve
11. Mban dosjen e mbikqyrjes së punimeve.
12. Merr njoftim me shkrim nga kontraktuesi (sipërmarresi) për perfundimin e punimeve së bashku me kontratën dhe aktet e lidhura? me të regjistrimin e kontabilitetit? procesverbalet e? dhenies, ndërprerjes të zgjatjes para dhe pas perfundimit të punimeve. kërkesat e tij.?
13. Verifikon të gjithë dokumentacionin e kontraktuesit brenda 15 ditëve nga perfundimi i punimeve.
14. Merr pjesë në kolaudimin e objektit.
15. Kontrollon dhe miraton situacionet e paraqitura nga kontraktuesi
16. Përcakton vlerën perfundimtare të objektit.
17. Merr pagesën për punën e kryer sipas dispozitave në fuqi.

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Sektori i depove Peqin

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR³

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

³ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: ? oferta ekonomikisht më e favorshme ?çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj.____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15.

KUSHTET E PËRGJITHSHME Shërbimet –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjijtjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termet e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 5 Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtonte ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6 Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

- 7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi.
- 7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
